



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Tiranë, më 09.01.2024

NJOFTIM

Në mbledhjen e zhvilluar në datën 08 janar 2025, Bordi i ERE-s shqyrtoi dhe mori vendime mbi:

1. Shqyrtimin e kërkesës së ardhur nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., mbi ndryshimin e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë si dhe rivlerësimin e kostove të FSHU sh.a. që përcaktojnë këtë çmim nga data 1 Shkurt 2025, dhe përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë për periudhën 1 Shkurt 2025 – 31 Dhjetor 2025, për konsumatorët që furnizohen në kushtet e furnizimit universal si më poshtë:
 - a. Për konsumatorët familjarë që konsumojnë më pak se **700 kWh në muaj – 8.5 Lekë/kWh pa TVSH.**
 - b. Për konsumatorët familjarë që konsumojnë **701 kWh në muaj, e më tej – 9.5 Lekë/kWh pa TVSH** për të gjithë sasinë e konsumuar duke filluar nga kWh i parë.
2. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2024 prej 18.77 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.